




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH

SHËNIME PËRMBLEDHËSE TË TAKIMIT TË PARË TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH

Nën kryesimin e kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi dhe drejtorit të Drejtorisë së z. Avni Morina u mbajt takimi i parë për këtë vit me drejtorët e shkollave dhe koordinatorë të cilësisë.

Takimi filloi në orën: **12:00 (7. 2. 2024)**, në këtë takim të pranishëm kanë qenë 46 pjesemarrës, 33 meshkuj e 13 femra.

Paneli:

- Z. Avni Morina, drejtor i DKA;
- Z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës.

Të pranishëm ishin edhe:

- Drejtorë shkollash
- Koordinatorë të cilësisë.
- Psikologë
- Pedagogë
- Policia
- Pjesëtarë të Kforit

REND DITE

- Bashkëbisedim për gjendjen aktuale në shkolla, fillimi i vitit dhe siguria në shkolla

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM:

Avni Morina, drejtor i DKA: I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe përmendi të arriturat, sfidat dhe vështirësitë që e karakterizuan vitin 2023. Përgatitjet për një fillimvit të ri, poashtu diskutoi rreth planeve për vitin 2024. Foli për të hyrat buxhetore dhe aktivitetet e drejtorisë. I falënderoi të gjithë për punën dhe angazhimin.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ju jemi mirënjohës për punën e juaj si dhe angazhimin që e tregoni çdo ditë, i gjithë personeli arsimor, po ashtu edhe teknik. Foli për temat që kanë të bëjnë me gjendjen e përgjithshme të arsimit në komunën tonë, për mundësitë e rritjes në vazhdimësi të cilësisë së shërbimeve dhe investimet kapitale që po bëhen dhe ato që planifikojnë t'i bëjnë në arsim. Kërkoj angazhim më të lartë në punë dhe potencoi dhe orët e humbura nga mësimdhënësit e shkollave dhe apeloj drejtorët e shkollave që këtë vit të ketë sa më pak orë të humbura. Përmendi investimet në shkolla si fushat sportive poashtu një kontratë që ka të bëjë me rrethimin e shkollave. Përmendi poashtu dhe kontratën kolektive që po lë pasoja të mëdha në buxhetet e komunave.

Qerim Hoti- pjesëtar i policisë në Rahovec- I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe theksoi se policia në Rahovec ka hartuar plane dhe ka zhvilluar aktivitete të ndryshme për parandalimin e veprave penale, ku janë mbajtur ligjërata me shumë nxënës të komunës sonë. Do të implementohen masat e sigurisë për parandalimin e keqpërdorimit të internetit. Në fund apeloj te drejtorët për bashkëpunim për parandalimin e dukurive negative.

Setki Kryeziu, drejtor- I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i përmendi disa çështje, një mësimdhënëse nuk raporton asgjë dhe potencoi që punëtorët teknik që nuk kryejnë detyrat si duhet tu shqiptohet vëretje me shkrim dhe me gojë.

Ilir Kryeziu, drejtor- I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe potencoi që shkolla në Zoqisht ka nevojë për intervenime në renovime sepse po ka ankesa nga ana e prindërve.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit: Iu përgjigj Setkiut ku potencoi se nuk është rast i vetëm ajo, ka raste të ngjashme dhe në Drenoc. Ilir Kryeziut iu përgjigj që zgjidhja më e mirë për shkollën e Zoqishtit është renovimi me Eficiencë. E mbylli fjalimin duke iu uruar të gjithëve një fillim vit të ri shkollor.

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH

Lajmin e takimit të kryetarit me punonjësit shëndetësor mund ta gjeni në këtë vegëz:
<https://www.facebook.com/share/p/1AFJ3AKV1h/>

Takimi përfundoi në orën: 12:40


DËSHMI NGA TAKIMI I KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË KRYETARIT ME DREJTORË SHKOLLASH


Ardit Halilaj
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Rahovec, 10 shkurt 2024

